



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
Senati Akademik

Nr. 564 Prot

Shkodër, më 07.02.2020

**V E N D I M**

Nr. 80, datë 07.02.2020

**"PËR NJË SHTËSE NË VENDIMIN NR. 253, DATË 17.07.2019"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3/ç, neni 6 pika 30, neni 38, 49; VKM-së nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", (i ndryshuar me VKM nr. 723, datë 06.12.2018, si dhe VKM nr 778, datë 26.12.2018), Statutit të USH-së i vitit 2018, neni 5, neni 17, pika 6/nj; neni 28, rregullores së studimeve të universitetit miratuar me vendimin e SA nr.182 datë 28.05.2019, vendimit të Senatit Akademik nr. 253, datë 17.07.2019, vendimit të Bordit të Administrimit nr.277 datë 14.08.2019 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2019 – 2020, shkresës nr. 1036 prot datë 06.02.2020 të MASR "Mbi zbatimin e VKM nr.788 datë 26.12.2018 në mbledhjen e tij të datës 07.02.2020,

**Vendosi**

1. Të saktësojë për efekt zbatimi që përfutues të reduktimit në masën 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në ciklin e parë të studimeve do jenë ata studentë të cilët rezultojnë me notë mesatare të ponderuar mbi 6.0 dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

Prof. dr. Adem **BEKTESHI**

